

ANA LALAJ

**IMPLIKIMET E SHTETIT SHQIPTAR NË LUFTËN
CIVILE NË GREQI
1946-1949**

Pas Luftës së Dytë Botërore (LDB), për strukturat politike të shtetit shqiptar ruajtja e pavarësisë dhe integritetit territorial të vendit ishin detyra prioritare. Konferenca e Jaltës, në shkurt 1945, nuk kishte marrë vendime të posaçme për Shqipërinë, gjë që linte të kuptohej se statusi i saj politik dhe kufijtë e saj ishin akoma çështje të negociueshme. Edhe një Traktat Miqësie dhe Ndihme Reciproke midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, i nënshkruar nga vetë Josip Broz Tito në shkurt 1945 (në fakt dhjetor 1944)¹ ishte anuluar nga Stalini, si i parakohshëm.² Marrëdhëniet me ish Aleatët e Mëdhenj të Luftës ishin afektuar nga ngjyrimet politike përkatëse. Më 29 gusht 1946, kërkesa e Shqipërisë për anëtarësim në OKB nuk mori votat e nevojshme nga Komiteti për pranimin e anëtarëve të rinj, ngritur pranë Këshillit të Sigurimit.³ Më 22 tetor 1946 ndodhi incidenti i kanalit të Korfuzit,⁴ i cili pamundësoi njëherë e përgjithmonë marrëdhëniet e shtetit komunist shqiptar me Britaninë e Madhe. Në fund të vitit 1946, misioni amerikan i pakënaqur

¹ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej: AMPJ), Viti (më tej: V.) 1945, Dosja (më tej: D.) 1. "Traktat mbi Aleancën dhe Ndihmën Mutuale midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë."*

² *Восточная Европа, в документах российских архивов, 1944-1953 гг.* Том I, 1944-1948 гг., Москва – Новосибирск: Сибирский хронограф, 1997, Документ № 37.

³ *AMPJ, V. 1946, D. 58, fl. 1-9. "Çështje e pranimit të Shqipërisë në U.N.O."*

⁴ Ana Lalaj, "Të fshehtat djegëse të Kanalit të Korfuzit", në *Studime Historike*, nr. 3-4/2010, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: 2011, f. 87-117. Më 22 tetor 1946, dy anije britanike që po kalonin në ujërat territoriale shqiptare, pranë Kanalit të Korfuzit, ranë në mina dhe nga shpërthimi i tyre vdiqën 43 ushtarë dhe oficerë britanikë, si dhe u plagosën po aq të tjerë. Britania e Madhe paraqiti padi kundër Republikës Popullore të Shqipërisë në Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës. Gjykata e Hagës mori vendim kundër Shqipërisë, e cila duhej t'i paguante si dëmshpërblim Britanisë së Madhe £844,000. Për shkak të incidentit të Kanalit të Korfuzit, në vitin 1946 Britania e Madhe ndërpreu bisedimet për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë. Ato u rivendosën vetëm në vitin 1991.

ngaurvejimet dhe kufizimet në rritje ndaj veprimtarisë së tij, u largua nga Shqipëria.

Përsa i përket raporteve të Shqipërisë me fqinjët, marrëdhëniet e saj politike me Jugosllavinë ishin mjaft të afërta, ndërsa marrëdhëniet me fqinjën jugore, Greqinë, përkeqësoheshin çdo ditë. Një masë e madhe popullsi çame ishte dëbuar nga trojet e saj për në shtetin shqiptar nën akuzën për “bashkëpunim me pushtuesit nazifashistë”, ku del i implikuar si nxitës edhe vetë shefi i misioneve britanike në Greqi, C.M. Woodhouse.⁵ Gazetat e djathta ekstremiste greke dhe ato proqeveritare bënin thirrje për pushtimin e Shqipërisë Jugore [të ashtuquajturit Vorio Epir] dhe të gjithë Shqipërisë. Më 26 qershor 1945, gazeta *Kathemirini* shkruante: “Ashtu si Cato, që çdo fjalim të tij e mbyllte me fjalët ‘Delenda Cartago’ (duhet shkatërruar Kartagjena), ashtu edhe Greqia çdo veprim të saj duhet ta mbarojë me frazën ‘Duhet pushtuar Shqipëria’.”⁶ Kryeministri dhe ministri i Jashtëm Cالدaris (Konstantinos Tsaldaris)*, u shpreh në Konferencën e Paqes në Paris, gusht 1946, se Shqipëria ishte në gjendje lufte me Greqinë dhe si dëmshtëpërblim kërkoi ndryshimin e kufijve veriorë të Greqisë; ndërsa ish zëvendësministri i Jashtëm Filip Dragumis, pasi u kthye nga Konferenca e Paqes deklaroi: “Rivendikojmë gjithë Vorio-Epirin duke vënë kufijtë e tij në vijën Pogradec –Vlorë. Po ashtu kërkujmë që ishulli i Sazanit të jetë grek si pjesë e pandarë e ishujve Jon.”⁷ Le të kujtojmë se, në atë kohë, kërkesa greke për

⁵ Ελευθερία Μαντα, *Οι Μουσουλμανοί Τσαμηδες της Ηπειρου, 1923-2000*, Θεσσαλονικη: 2004, p. 312. Në librin e saj, studiuesja Elefteria Manta publikon një dokument të shkruar nga vetë C.M. Woodhouse, me titull “Një shënim mbi çamët”, më 16 tetor 1945, ku, midis të tjerash, thuhet se: “Zervas, i inkurajuar nga Misioni Aleat i drejtuar prej meje, i ndoqi ata nga shtëpitë e tyre në 1944, me qëllim që të lehtësonin operacionet kundër armikut ... Çamët e meritonin atë që morën, por metodat e Zervas ishin mjaft të këqija - ose më saktë - oficerët e tij vartës i dolën nga dora. Në fakt, rezultati ishte shpërngulja e popullsisë, duke u dëbuar si minoritet i padëshiruar nga toka greke”. Për më shumë shih: Beqir Meta, *The Cham Tragedy*, Tiranë: Klean, 2010.

⁶ *Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura* (më tej: *AQFA*), F. Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë (më tej: SHPU), Bobina 12, V. 1946, D. 282. Cituar sipas gazetës *Kathemerini*, 26 qershor 1945; *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme* (më tej: *AMPB*), Fondi (më tej: F.) Drejtoria e Zbulimit Politik, Viti (më tej: V.) 1946, Dosja (më tej: D.) 150. Shih gazetën *To Ethnos*, “Greqia dhe Epiri i Veriut”, 29 maj 1945.

* *Konstantinos Tsaldaris* (1884–1970), Kryeministër i Greqisë: 18 prill 1946 - 2 tetor 1946; 2 tetor 1946 - 25 janar 1947.

⁷ *AMPB*, F. Drejtoria e Zbulimit Politik, V. 1946, D. 150.

ndryshime kufijsh kishte në sfond mbështetjen britanike.⁸ Fakti është se akuzat dhe pretendimet tokësore kundër Shqipërisë nuk mbetën vetëm në rrafsh propagandistik. Provokacione të shumta të forcave të armatosura greke u ndërmorën kundër tërësisë territoriale tokësore dhe ujore të shtetit shqiptar, si dhe të hapësirave të tij ajrore.⁹ Qeveria greke që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore e më pas u kishte siguruar strehim disa autoriteteve shqiptare që kishin bashkëpunuar me pushtuesin gjatë LDB apo ishin kundërshtarë të politikës së qeverisë komuniste aktuale. Të gjitha këto bënin që Tirana zyrtare të ndjehej e kërcënuar dhe e shqetësuar për kufijtë jugorë të Shqipërisë. Mbrojtja e interesave nacionale ishte sfidë e vështirë për qeverinë shqiptare për ta përballuar e vetme, por jo më pak edhe në rreshtimin politik ku ajo ishte vendosur.

Pas Luftës së Dytë Botërore në vetë Greqinë, kishte zënë fill edhe një konflikt i armatosur ndërmjet formacioneve të Ushtrisë Kombëtare Greke dhe forcave kryengritëse të Ushtrisë Demokratike Greke [*Dimokratikos Stratos Elladas*: DSE më vonë DAG]. Ky konflikt me kohë hyri në histori me emërtimin *Lufta Civile Greke*. Megjithëse ishte e interesuar për të qetësuar marrëdhëniet me Greqinë fqinje, e madje të bashkëpunonte institucionalisht me të, qeveria shqiptare me rreshtimin e saj ideologjik komunist nuk mund të linte mënjane 'solidaritetin internacionalist', një slogan të cilit i mëshohej shumë në propagandën e partive dhe shteteve komuniste brenda dhe në arenën ndërkombëtare. Solidariteti politik midis *Partisë Komuniste Shqiptare* (më tej: PKSH)

⁸ *The National Archives*, London (më tej: TNA) Public Record Office (PRO), Foreign Office (FO) 371/37144. Britanikët kishin lënë një "derë të hapur" për ndryshimin e kufirit shqiptaro-grek, kur më 17 dhjetor 1942, Sekretari i Shtetit Anthony Eden iu përgjigj një pyetjeje në Parlament, se "Qeveria e Madhërisë së Tij e konsideron çështjen e kufijve të shtetit shqiptar pas luftës si një çështje, e cila do të duhet të shqyrtohet në zgjidhjet e paqes". ShiH gjithashtu: *po aty*, PRO, FO 371/22108, R 8604/184/90, kur më 30 dhjetor 1942, Eden i shkruajti ambasadorit grek, në Londër, M. Aghnides, se me Deklaratën e 17 dhjetorit 1942, "dera mbetej hapur dhe vetë deklarata e tanishme e ka bërë të qartë qëndrimin tonë përtej çdo dyshimi."

⁹ Beqir Meta, *Tensioni Greko-Shqiptar, 1939-1949*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: 2012, f. 169-269. Autori Meta në monografinë e tij jep një sinopsis të marrëdhënieve shqiptaro-greke në dhjetëvjeçarën e përmendur, e ndërmjet të tjerash, evidencon në mënyrë të detajuar aspekte të ndryshme të veprimtarisë diversioniste të shtetit grek kundër Shqipërisë, duke filluar që nga fushatat diplomatike, zhurmën dhe akuzat antishqiptare të gazetave qeveritare greke, provokacionet e armatosura kufitare tokësore dhe detare, mitingjet me fjalime agresive të organizuara nga grupet ekstremiste nacionaliste greke etj.

dhe Partisë Komuniste Greke (*Kommunistiko Komma Elladas*, më tej: KKE), kishte filluar që në vitet e Luftës së Dytë Botërore.¹⁰ PKSh duke pasur shpresë për një fitore të komunistëve grekë dhe ardhjen e tyre në pushtet, e shihte dhe më të sigurt pushtetin e saj pas Luftës. Ky perceptim ishte i njëjtë për të gjitha partitë e tjera të Bllokut Komunist, që e konsideronin forcimin e pushtetit të tyre brenda vendit, të lidhur ngushtë me pushtetin e partisë homologe “motër”, në rastin konkret të KKE. Sot kur janë hapur arkivat e PKBS dhe të partive të tjera të Bllokut Komunist, kuptohet qartë teknika e funksionimit të KKE në plan kombëtar dhe ndërkombëtar për të forcuar pushtetin e saj. Regjistrimet arkivore provojnë si iniciativat e KKE dhe sidomos kryetarit të saj, Niko Zahariadis, për të siguruar ndihma në armatime, në strehime, trajnime, medikamente mjekësore dhe pajisje propagandistike nga qeveritë komuniste të Ballkanit dhe Evropës Lindore, ashtu dhe gatismërinë e këtyre të fundit për të mbështetur kryengritjen e gueriljeve greke. Në këtë bashkëpunim ilegal ndërkombëtar të partive komuniste fqinje dhe të Evropës Lindore me KKE, PKSH-ja nuk mund të qëndronte e veçuar. Kësisoj, qeveria shqiptare u përfshi në veprimtarinë ilegale në mbështetje të KKE. Sigurisht një rrugë e pritshme mund të ishte neutraliteti i Shqipërisë në konfliktin e brendshëm grek. Por nuk ndodhi kështu. Shqipëria u bë faktor aktiv ilegal i njëanshëm në Luftën Civile në Greqi. Ajo u përfshi në një lojë të rrezikshme për pavarësinë dhe integritetin e vendit të saj, lojë që nxiti orekset pushtuese të qarqeve nacionaliste të skajshme greke deri te qeveria e saj.

Risku që mori përsipër udhëheqja politike shqiptare ishte i kushtëzuar edhe nga një *arsye e dytë*, ai ishte raporti i marrëdhënieve shqiptare - jugosllave të kohës. PKJ konsiderohej partia në pushtet më e rëndësishme në Ballkan, dhe, për Partinë Komuniste Shqiptare kishte ndikuar në organizimin e saj që nga krijimi. PKJ, partia e vetme në pushtet në Jugosllavi, luajti me dy vatra për interesat e saj: Maqedoninë greke dhe Shqipërinë. Studiues të ndryshëm* kanë nënvizuar se Jugosllavia ka qenë vendi më i interesuar dhe më i angazhuar në Luftën Civile në Greqi për shkak të synimeve të saj ndaj Maqedonisë: një

¹⁰ Sonila Boçi, “Minoriteti grek në Shqipëri midis rezistencës shqiptare dhe asaj greke, 1942-1944”, në *Studime Historike*, nr. 3-4/ 2008, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: 2009, f. 133-156.

* Andrew Rossos, Nikos Marantzidis, Peter J. Stavrakis, John O. Iatrides, Thanasis D. Sfikas, Nikolas Papas, Kostis Karpozilos, Basil Kondis, Amikam Nachmani etc.

Maqedoni e bashkuar, e Vardarit, e Pirinit dhe e Egjeut, në kuadër të Federatës Jugosllave.¹¹ Kjo temë është trajtuar jo vetëm në takimet sekrete midis drejtuesve politikë jugosllavë, por këta të fundit janë deklaruar edhe hapur në median e kohës.¹² Është i njohur fakti se Fronti Nacionalçlirimtar [*Narodni Osvoboditelni Front*, më tej: NOF] i Maqedonisë së Egjeut kishte shumicën në DAG, ashtu siç është e njohur që KKE për të kapur pushtetin me luftë, shfrytëzoi edhe luftën e sllavo-maqedonasve në Greqi që synonin të realizonin ambiciet e tyre për çlirim nacional apo autonomi. Kësisoj, KKE dhe sllavo-maqedonasit e Greqisë megjithëse gjendeshin në një krah të Luftës Civile në Greqi, si komunistë apo simpatizantë të komunistëve, ata ishin aleatë të paharmonizuar deri në fund.¹³ Megjithatë, Tito mbështeti luftën e KKE dhe të maqedonasve në Greqi kundër qeverisë mbretërore greke, pasi vetëm nëse fitohej kjo luftë nga komunistët, simpatizuesit e tyre dhe patriotët maqedonas, vetëm atëherë mund të arrihej te Maqedonia e bashkuar, te federata e zgjeruar jugosllave e më në fund te një federatë ballkanike, e cila ishte dhe synim strategjik internacionalist për të.

Përsa i takon Shqipërisë, ajo ishte projektuar në vetëdijen e klasës politike të udhëheqjes jugosllave si pjesë e Federatës Jugosllave. Le të kujtojmë për këtë rolin ndërmjetësues që luajtën emisarët jugosllavë në krijimin e PKSH; organizimin e strukturave partiake, ushtarake dhe politike të LANÇ në Shqipëri sipas shembullit jugosllav; bisedën e

¹¹ *Восточная Европа, в документах российских архивов, 1944-1953 гг....*, Том I, Документ № 37. Ky dokument përshkruan një bisedë të gjatë midis Stalinit dhe Andria Hebrang, kryetarit të delegacionit të Komitetit Nacionalçlirimtar të Jugosllavisë, më 9 janar 1945, në Moskë. Në këtë bisedë trajtohet edhe çështja territoriale pas Luftës së Dytë Botërore. Hebrang iu përgjigj një pyetjeje të Stalinit në lidhje me Greqinë, nëse "Jugosllavia llogarit për të shkëputur Maqedoninë Greke dhe Selanikun nga Greqia?" Hebrang u përgjigj se nëse kjo kërkesë nuk ishte dorëzuar deri atëherë, kjo gjë kishte ndodhur vetëm për shkak që "të mos shkaktojë vështirësi për ELAS-in (Ushtria Çlirimtare e Popullit Grek) brenda vendit." Gjatë LDB e më pas, sllavo-maqedonasit ishin më aktivët në ELAS.

¹² TNA, PRO. FO 371.78330. Artikull "Për çështjen e Federatës ballkanike", shkruar nga Moša Pijade, anëtar i Byrosë Politike të KQ të PKJ, në gazetën *Borba*, Beograd, më 6 prill 1945.

¹³ Andrew Rossos, "Incompatible Allies: Greek Communism and Macedonian Nationalism in the Civil War in Greece, 1943, 1949, in *The Journal of Modern History*, Vol. 69, No. 1, United States: The University of Chicago Press, March., 1997, pp.42-76.

Andrei Hebrangut me Stalinin, më 5 janar 1945,¹⁴ ku këtij të fundit iu kërkua hapur përfshirja e Shqipërisë në Jugosllavi; bisedën e Titos me Stalinin në maj 1946, kur Tito u shpreh drejtpërdrejt se “ne duhet të dimë, nëse kufiri ynë do të jetë përgjatë Shqipërisë apo bregdetit.”¹⁵ Për sa kohë që gjithë kjo veprimtari bëhej me dijeninë dhe lejen e Stalinit, ky i fundit do të inkurajonte Titon (maj 1946)¹⁶ dhe Hoxhën (korrik 1947),¹⁷ për marrëdhënie miqësore të ngushta shqiptare-jugosllave.

Nuk ishte e rastit, që vetëm një muaj pasi u takua me Stalinin, Tito ftoi Enver Hoxhën në Beograd. Tito e kishte shtyrë tre herë vizitën e Hoxhës në kryeqytetin jugosllav, me qëllim që të merrte miratimin e Stalinit. Gjatë vizitës së Hoxhës në Beograd, më 23 qershor deri më 2 korrik 1946, ashtu siç ishte parashikuar në Moskë u përgatit një Traktat Miqësie, Bashkëpunimi dhe Ndihme Reciproke ndërmjet Shqipërisë e Jugosllavisë, si dhe u bisedua për “të gjitha çështjet ushtarake që u interesonin të dy vendeve.”¹⁸

¹⁴ *Восточная Европа, в документах российских архивов, 1944-1953 гг. Том I, 1944-1948 гг....*, Документ № 37.

¹⁵ Yugoslav Record of Conversation of I. V. Stalin and Yugoslav Government Delegation Headed by J. Broz Tito, 27-28 May 1946 në *Cold War International History Project (CWIHP) Bulletin*, Issue 10, Woodrow Wilson International Center for Scholars, Washington DC, March 1998, p. 121. L. Studiuesi Leonida Gibianski shënon si burim për këtë material AJT KMJ I-1/7. L. 6-11. *Original. Manuscript.*

¹⁶ Po aty, p. 122. "Si rezultat, vazhdoi shoku Stalin, do të ishte e mençur që së pari të shqyrtojmë çështjen e miqësisë dhe ndihmës së ndërsjellë midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Tito tha se, mbi të gjitha, ky traktat duhet të sigurojë mbrojtjen e integritetit territorial dhe pavarësisë kombëtare të Shqipërisë. Shoku Stalin tha se është e rëndësishme të gesh një formulë për këtë traktat dhe të afrosh Shqipërinë dhe Jugosllavinë më afër."

¹⁷ *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), F. 14/AP-MPKBS, V. 1947, L. 1, D. 1, fl. 1-8. "Shënime të Enver Hoxhës në takimin me Stalinin në Moskë, 16 korrik 1947."

¹⁸ *Восточная Европа, в документах российских архивов, 1944-1953 гг....*, Том I, Документ № 159. Ambasadori sovjetik në Shqipëri, D.S.Çuvahin, shkruan në ditarin e tij që Enver Hoxha i kishte thënë se "Tito shfaqti një interesim të madh për çështje të tilla, si gjendja e ushtrisë shqiptare, dislokimi i reparteve të saj, armatimi, furnizimi dhe planet e Shtabit të Përgjithshëm Shqiptar në rast lufte. Tito u interesua mandej për gjendjen e tanishme të mbrojtjes si të kufijve tokësorë, ashtu edhe të atyre detarë të Shqipërisë, po ashtu edhe për gjendjen e aerodromeve që ekzistojnë në vend ... Shqipërisë i duhet të merret para së gjithash me forcimin e kufijve të vet jugorë që ka përballë Greqisë, si edhe të bregdetit."

Në fakt, pas kthimit të Hoxhës nga Beogradi, në vend u ndërmor një fushatë intensive minimesh në gjithë vijën kufitare jugore, bregdetare dhe tokësore, në ura dhe në rrugë automobilistike. Po atë muaj, në korrik, Hoxha i kërkoi Shtabit të Ushtrisë Jugosllave përveç automjeteve për ushtrinë edhe 100 mijë mina kundër këmbësorisë dhe 100 mijë mina të tjera kundërtanke, tel me gjemba, kabull telefonash, stacion radioje etj. Pikërisht kjo situatë u bë shkak edhe për incidentin e shumëpërfolur të kanalit të Korfuzit, ku u vranë 43 marinarë dhe oficerë britanikë. Hapja e arkivave shqiptare kohët e fundit ka vërtetuar se minat ishin vënë nga jugosllavët me pëlqimin e qeverisë shqiptare, e cila nuk zotëronte instrumentet e nevojshme për vendosjen e tyre.¹⁹ Megjithëse u viktimizuan 43 britanikë, në fakt minat nuk ishin vënë kundër anglezëve por kundër ushtrisë greke, formacionet e së cilës kryenin herë pas here provokacione në kufijtë e Shqipërisë. Qeveria jugosllave punonte aktivisht dhe seriozisht për mbrojtjen e kufijve të Shqipërisë së Jugut, të cilët i shikonte si kufijtë e saj të ardhshëm. Ajo dërgoi në Shqipëri specialistë dhe literaturë ushtarake, armatime, tanke etj. Instruktorët e këshilltarët jugosllavë dhe sovjetikë ishin të kudogjendur, në Komandën e Shtabit të Përgjithshëm, në divizionet, në brigadat e në batalionet shqiptare; merrnin pjesë në organizimin e planeve operacionale ushtarake, në stërvitjet e formacioneve ushtarake, në projektimin dhe ndërtimin e rrugëve dhe aerodromeve në jug të vendit etj.²⁰

Në gjithë këtë veprimtari, ruajtja e sigurisë kombëtare të Shqipërisë u lidh ngushtë me mbrojtjen e saj nga një sulm grek. Jugosllavia shfrytëzoi më së miri faktin se Shqipëria nuk mbrohej dot e vetme ushtarakisht, pasi i mungonin armatimet në tokë, ajër dhe det, i mungonin ushqimet dhe veshmbathjet. Duke konstatuar shqetësimin e udhëheqjes shqiptare, jugosllavët i dhanë sulmit grek ndaj Shqipërisë përmasa të ekzagjeruara dhe arritën ta kthejnë atë në një “mit”. Madje, edhe kur pati zëra se nuk kishte të ngjarë të kishte një sulm të mundshëm grek kundër Shqipërisë,

¹⁹ A. Lalaj, “Të fshehtat djegëse të Kanalit të Korfuzit ...”; shih gjithashtu: Ana Lalaj, “Incidenti i Kanalit të Korfuzit, të dyja palët janë përgjegjëse”, në *Panorama*, Tiranë: 10 dhjetor 2009; shih edhe: Paskal Milo, *Të vërtetat e fshehura. Incidenti i Kanalit të Korfuzit*, Tiranë: Toena, 2010.

²⁰ AQFA, F. Shtabi Përgjithshëm i Ushtrisë Popullore, Bobina 9, V. 1946, D. 10. f. 7, 10, 11, 12, 13, 14.

ata u fshikulluan ashpër, siç ndodhi me Sejfulla Malëshovën.²¹ Shqiptarët u treguan të gatshëm të pranojnë edhe dy divizione ushtarake jugosllave në Shqipëri. Pala shqiptare këto dy divizione i shikonte si mbrojtje të integritetit, kurse pala jugosllave i shikonte si mundësi për të provuar forcën me grekët për Shqipërinë dhe jo vetëm. “Të hymë dhe pastaj secila palë të marrë ç’ të mundet”²², shprehej Kardeli në një mbledhje të Byrosë Politike të PKJ, më 1 mars 1948.

Siguria nacionale që ofronte Jugosllavia me ndihmën e saj ushtarake për Shqipërinë ishte një moment me rëndësi, që prevalonte mbi të tjerët në gjeostrategjinë e shtetit shqiptar, dhe, si i tillë bëhej imponues ndaj sjelljes së shqiptarëve. Në shkëmbim, Jugosllavia kërkoi nga Shqipëria angazhimin në Luftën Civile në Greqi. Sigurisht përqasja nuk ishte e njëjtë, Jugosllavia ndodhej në pozita ekspansioniste, ndërsa Shqipëria në pozita mbrojtëse. Madje kjo e fundit edhe po përdorej.

Arkivat shqiptare provojnë se që në vitin 1946 u ngritën struktura të caktuara pranë Ministrisë së Brendshme që do të merreshin me çështjen greke. Ato struktura ishin nën juridiksionin e drejtpërdrejtë të ministrit shqiptar të Punëve të Brendshme, Koçi Xoxe.* Gjithashtu dëshmohet se kjo veprimtari ishte shumë konspirative dhe se ishin jugosllavët ata që përcaktonin dhe kontrollonin ecurinë e kësaj veprimtarie. Kjo bëhej si në takime me kuadro të lartë të OZN²³-as ashtu dhe nëpërmjet letërkëmbimit me korrierë të besuar.²⁴

²¹ AQSH, F. 14-Organet Udhëheqëse (OU), V. 1946, D. 1/1, fl. 38. Plenumi V i KQ PKS, 21 shkurt 1946.

²² *Izvori za istoriju Jugoslavije, Politbiro Centralnog Komiteta Komunističke Partije Jugoslavije 1945-1948*, Përgatitur nga Branko Petranović, Beograd: Izdavači Arhiv Jugoslavije, Službeni list SRJ, 1995, f. 240. Sipas këtij volumi dokumentesh, fjalia e fundit e Kardelit është: “Ne bi išla sama divizija već bi išli sa većim snagama, pa šta ko ugrabi.”; Ivo Banac, *With Stalin Against Tito. Cominformist Splits in Yugoslav Communism*, Ithaka and London: Cornell University Press, 1988, p. 42; shih gjithashtu: Branko Petranović, *Balkanska Federacija, 1943-1948*, Beograd: Edicija Svedočanstva, 1991, s. 200.

* *Koçi Xoxe* [1911-1949]. Sekretar i KQ të PKS (1943-1948), Zëvendëskryeministër (1944-1948), ministër i Brendshëm (1946-1948). U përjashtua nga PKS dhe u shkarkua nga të gjitha funksionet partiake, politike dhe shtetërore me akuzën për veprimtari agjenturore projugosllave. U pushkatua më 11 qershor 1949.

²³ OZN-a (*Odeljenje za Zaštitu Naroda. Organizata për Mbrojtjen e Popullit*), që nënkupton organet e Sigurimit të Shtetit. OZN-a u krijua më 13 maj 1944 nën drejtimin e Aleksandar Ranković [1909-1983], Kryeministër, ministër i Brendshëm, anëtar dhe sekretar organizativ i Byrosë Politike të PKJ dhe një nga bashkëpunëtorët

Le të japim një shembull. Kur më 19 dhjetor 1946, Këshilli i Sigurimit vendosi të ngrejë një komision hetimor që do të vëzhgonte gjendjen në Shqipëri, nga Beogradi, Aleksandar Rankoviçi, zëvendëskryeministër dhe ministër i Brendshëm në Jugosllavi, i dërgoi mesazh ministrit të Brendshëm shqiptar, K. Xoxe, ku i shkruante se për shkak të presionit të jashtëm ishte krijuar një situatë mjaft e vështirë dhe se në ato momente “do të ishte rrezik shumë i madh t’u dërgonin materiale miqve tanë (gueriljeve greke-A.L.). Nuk duhet bërë fare fjalë mbi faktin që ne ju dërgojmë atyre materiale, qoftë nga ana jonë apo e juaja.”²⁵ Ky mesazh që konfirmon se tek partizanët grekë shkonin vërtet në rrugë ilegale furnizime nga Jugosllavia dhe Shqipëria, bën gjithashtu me dije dhe shqetësimin e jugosllavëve për rrezikun e ndërkombëtarizimit të kësaj çështjeje. Reagimi shqiptar ishte i menjëhershëm. Të nesërmen, Koçi Xoxe, urdhëronte strukturat e Sigurimit (atëkohë quhej *Arma e Mbrotjtjes Popullit*): “Do të ndaloni çdo ndihmë që u jepet grekëve. Që tash asnjë gjë sado e vogël qoftë të mos kalojë kufirin. E përsërisim asnjë gjë.”²⁶

Megjithatë, po atë ditë A. Rankoviçi i dërgoi një telegram të dytë K. Xoxes, me të cilin e njoftonte se në Tiranë do të vinte koloneli Vojislav Biljanoviçi, për të studiuar bashkërisht mundësitë e dërgimit të materialeve për partizanët grekë. “Në këtë rast, thuhej në telegram, ne do të mund të krijojmë një aparat shumë të fshehtë, i cili do të merret vetëm me këtë punë. Mbi bazën e njoftimeve të Biljanoviçit dhe propozimeve tuaja, do të marrim vendimin. Duhet të kini parasysh se kemi të bëjmë me një punë shumë të rrezikshme dhe si rrjedhojë e një pune të pakujdesshme mund të lindin pasoja të mëdha si për ju dhe për ne.”²⁷ Shihet qartë se jugosllavët e kaluan brenda ditës dilemën, çka do të thotë

më të afërt të Titos deri në korrik 1966. Më 1946, OZN-a u shpërbë dhe si organi kryesor i Sigurimit të Shtetit u krijua UDB [Uprava Državne Bezbednosti].

²⁴ AMPB, F. 54/Drejtoria e Zbulimit Politik, V. 1946, D. 93. Në këtë dokument shkruhet: “Miço Karanxha, oficer i OZN-as të Manastirit, mbasi solli natën në Goricë të 75 të NOF-it dhe meqënëse binte shi, vendosi t’i përcjellë deri në Bilisht”.

²⁵ AQSH, F. 14/AP-MPKJ, V 1946, D. 7, Tel. nr. 73, Gr. 106. Shokut Zllatiç për ministrin Koçi Xoxe, 19 dhjetor 1946.

²⁶ AMPB, F. 54/ Drejtoria e Zbulimit, V. 1946, D. 101, fl. 81. Telegram nr. 56, nr. 02-1634 Prot. Tepër urgjent i Koçi Xoxes dërguar strukturave vendore, dt. 20 dhjetor 1946.

²⁷ AQSH, F. 14/AP-MPKJ, V. 1946, D. 7, Tel. nr. 75, Gr. 141. Shokut Zllatiç për ministrin Koçi Xoxe, 19 dhjetor 1946.

se ndihma ndaj partizanëve grekë për ta ishte shumë e rëndësishme. Ishte kjo një porosi e sovjetikëve apo thjesht interes jugosllav, mbetet ende për t'u saktësuar. Ndoshta ishin të dyja.

Në vitet e para të Luftës Civile në Greqi, Shqipëria u përdor si vend transit për kalimin e atyre grekëve të ardhur nga Bulkësi (Vojvodinë), që kishin marrë përsipër të organizonin lëvizjen e rezistencës me armë në Greqi, të quajtur “Lëvizja e armatosur e demokratëve të ndjekur”. Kjo lëvizje u shtri sidomos në Maqedoni dhe në Epir²⁸, zona këto në kufi me Shqipërinë. Të dhënat e para në arkivat shqiptare për kontaktet me këtë lëvizje datojnë që në vitin 1945, kur në Rubik u ngrit një kamp, në të cilin përgatiteshin kuadro të zbulimit e kundërzbulimit për guerilast grekë.²⁹ Në prill 1945, rreth 400 kuadro të KKE, viktima të persekutimit nga autoritetet shtetërore greke gjetën strehim. Ata mbetën aty deri në tetor 1945.³⁰ Muaj më pas, bashkëpunimi ndërmjet dy partive komuniste u zgjerua dhe më 30 maj 1946, në Gjirokastrë, erdhi anëtari i Qarkorit Politik të Kosturit, Leonidha Rafti. Ai zhvilloi bisedime me drejtues shqiptarë të Sigurimit të Shtetit, emrat e të cilëve në dokumente janë të koduar. Nga dokumentacioni del qartë se ai ka informuar për njësitet sulmuese që janë krijuar dhe ka kërkuar vendosjen e lidhjeve të rregullta midis Tiranës zyrtare dhe lëvizjes së re. Gjithashtu ai kërkoi armatime për njësitin e tij në Pogonin grek, të cilat iu dhanë menjëherë.³¹ Por dy muaj më vonë, në mesin e gushtit 1946, Leonidha Rafti u kap rob nga forcat qeveritare greke, u nxor në gjyq dhe u ekzekutua.³² Pas vrasjes së tij, lidhjet vazhduan me Janulisin, komandantin e Shtabit të Gramozit. Në rajonet kufitare shqiptare strehoheshin guerilas grekë, u ndërtuan depo për armatimet që u dërgoheshin guerilasve dhe më 9 dhjetor, në

²⁸ AMPB, F. 54/Drejtoria e Zbulimit Politik, V. 1946, D. 111. Sipas dokumentit “ata grekë do të çonin në Greqi eksperiencën dhe taktikën e luftës partizane në Shqipëri dhe Jugosllavi, do të godisnin postat e policisë greke (korofilaqisë) dhe do të formonin pak nga pak zonat e lira”.

²⁹ AMPB, F. 54/Marrëdhëniet e PKS me PK Greke, V. 1945, D. 14.

³⁰ Nikos Marantzidis, “The Greek Civil War (1944–1949) and the International Communist System”, në *Journal of Cold War Studies*, Volume 15, Number 4, MIT Press, Harvard University Faculty of Arts & Sciences, Cambridge, USA: Fall 2013, p. 34.

³¹ AMPB, F. 54/Drejtoria e Zbulimit Politik, V. 1946, D. 101, fl. 5. Bisedë me gjeneralin (Markos) dhe armatimet që iu dhanë, dt. 4 qershor 1946.

³² *Po aty*, fl. 10. Tel. 505/1. Prot, 6.8.1946. Informacion mbi vrasjen e Leonidha Raftit.

Voskopojë, u hap dhe një spital për mjekimin e të plagosurve.³³ Tirana mbahej e informuar për të gjitha zhvillimet politike dhe luftarake të rëndësishme që po ndodhnin në Greqi, si p.sh. për krijimin e “Shtabit të Përgjithshëm” dhe për organizimin e “Ushtrisë Demokratike Greke”³⁴, të kryesuar nga komandanti Marko Vafiadhis.*

Ndër takimet ndërmjet drejtuesve ushtarakë e politikë grekë e shqiptarë, mund të përmendim atë të shtatorit 1947, kur gjenerali Markos, komandanti i Shtabit të DAG, mbërriti në Tiranë pa njoftuar paraprakisht. Sipas një letre që Enver Hoxha i ka dërguar Titos më 24 shtator 1947,³⁵ Markos kishte kërkuar që nga popullsia çame e ardhur në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore, të dilnin tre deri në katër mijë vetë për t’u bashkuar me DAG. Po kështu edhe 2500 të ikurit e deriatëhershëm nga Greqia në Shqipëri, të mblidheshin në tri a katër qendra dhe të dërgoheshin në luftë. Kërkoi edhe disa topa të kalibrit 75 mm. Kuptohet, u fol edhe për gjendjen e ndihmave në ushqime e veshmbathje. Enver Hoxha e informoi Titon se do t’u dërgonte guerilasve grekë disa topa, ndërsa për sa i takonte mundësisë për të mobilizuar ushtarë nga popullsia çame, këtë e shihte shumë të vështirë, gjë që u provua në vijim.³⁶

³³ AMPB, F 54/Drejtoria e Zbulimit Politik, V. 1946, D. 101, 111, 112.

³⁴ *Shtabi i Përgjithshëm Partizan* në Greqi u krijua më 28 tetor 1946, datë e cila njihet si momenti i themelimit të Ushtrisë Demokratike të Greqisë (DAG). Ndërsa dy muaj më vonë, më 27 dhjetor 1946, u bë riemërimi zyrtar, kur Shtabi i Përgjithshëm Partizan lëshoi *urdhrit* e emërimit të trupave partizane “*Ushtria Demokratike e Greqisë*”.

* *Markos Vapheiadis* [1906 - February 23, 1992], figurë udhëheqëse e Partisë Komuniste e Greqisë (KKE) komandant i Ushtrisë Demokratike Greke (DAG) [tetor 1946- janar 1949], kryetar i qeverisë Demokratike Provizore Greke (dhjetor 1947-gusht 1948).

Figurë udhëheqëse e Partisë Komuniste të Greqisë (KKE), komandant i Ushtrisë Demokratike Greke (tetor 1946- janar 1949) dhe kryetar i qeverisë Demokratike Provizore Greke (dhjetor 1947- gusht 1948), ministër i Luftës. Gjatë fazave të fundit të Luftës Civile mosmarrëveshjet e tij me Zachariadis për çështje të doktrinës ushtarake si dhe për disa dyshime se kishte marrëdhënie të afërta me PK të BS (pas Rezolucionit të Informbyrosë në qershor 1948) çuan në largimin e tij nga udhëheqja (gusht 1948) dhe më vonë nga të gjithë postet (janar 1949). Në tetor 1950, ai u përjashtua nga KKE, dhe pas një qëndrimi të përkohshëm në Shqipëri shkoi në BS.

³⁵ *Arhiv Jugosllavije* (më tej: *AJ*), Arhiv Predsednika Republike, Kabinet Maršala Jugosllavije I-3-b/32, 24. IX. 1947, 31. Letër e Enver Hoxhës dërguar J.B. Titos, më 24 shtator 1947.

³⁶ Gjatë luftës, KKE i ftoi nënshtetasit grekë, kudo që ndodheshin, t’i bashkoheshin DAG-së. Udhëheqësit shqiptarë u përpoqën ta shfrytëzonin këtë ftesë për të mobilizuar çamët e dëbuar nga Greqia. Por kjo përpjekje nuk pati sukses. Arsyeja është se

Disa muaj më parë, në maj 1947, edhe Niko Zahariadhis ishte takuar me J.B.Stalin, nga i cili dukej se kishte marrë mbështetje, pasi kërkesat greke për armë ishin shqyrtuar pothuajse në muajin pasardhës. Drita jeshile që u hap në Moskë i vuri në lëvizje satelitët e saj. Më aktivi u tregua Tito, i cili shpejtoi ta shfrytëzonte këtë çast edhe për interesa nacionalë, kur Maqedonia e Egjeut ishte më e përfshira në lëvizjen partizane greke, por edhe për interesa politikë, në kërkim të rolit të tij si lider i Ballkanit. Edhe udhëheqësit e tjerë eurolindorë treguan se ishin rreshtuar pa mëdyshje në krah të partizanëve grekë. Ndihamat e arritura nga Shqipëria dhe Bullgaria, gjithashtu i përcilleshin kryengritësve grekë përmes Jugosllavisë.³⁷

Në komisionin përgatitor të Deklaratës së mbledhjes themeluese të Kominformit/ Informbyrosë, në shtator 1947, delegati bullgar V.Çervenkov, delegati jugosllav E.Kardel dhe ai rumun G.Dezh, kërkuan që në Deklaratë të fiksohej ndihma e detyrueshme për partizanët grekë. Delegati sovjetik, A.Zhdanov, iu shmang një formulimi me shkrim, por megjithatë u pranua se “t’i jepje ndihmë KKE ishte detyrim për të gjitha partitë komuniste, por pa e shkruar këtë në Rezolutë.”³⁸

Qëndrimi ndaj problemit grek është diskutuar edhe gjatë vizitës së Enver Hoxhës në Sofje, në dhjetor 1947. Në një takim midis ministrit të Brendshëm bullgar Anton Jugov dhe, atij shqiptar, Koçi Xoxe, ku mernte pjesë dhe Hoxha me statusin e ministrit të Mbrojtjes, janë përcaktuar format e “shkëmbimit të informacionit” për Greqinë, organizimi i “lidhjeve ushtarake” midis Shqipërisë dhe Bullgarisë, deri te hartimi i një

popullsia çame, historikisht e keqtrajtuar nga shteti grek, e kishte humbur besimin të grekët, pavarësisht orientimit të tyre politik. Në Byronë Politike të PPSH pati propozime dhe për një mobilizim të detyruar, qoftë edhe në mënyrë të dhunshme, por u hoq dorë shpejt, pasi çamët mbanin ende nënshtetësinë greke, pra konsideroheshin nënshtetas të huaj. U tha se ky veprim, nëse merrej vesh, mund të sillte komplikacione ndërkombëtare. (AQSH, F. 14/AP-OU, V. 1949, D. 16). Madje edhe për ata pak çamë që u bashkuan me partizanët grekë, gjithsej 130 vetë, kjo u bë fshehtas, nën pamjen e një organizimi vullnetar të vetë komunitetit çam. Ndërkohë ata çamë, anëtarë partie, që refuzuan të hynin në DAG, u përjashtuan nga partia ose u internuan në kampe (*Po aty*, F. 14/AP- Strukturë, V. 1949, D. 389).

³⁷ N. Marantzidis, “The Greek Civil War (1944–1949) and the International Communist System ...”, p.33.

³⁸ Leonida Gibianskii, “От первого ко второму совещанию Коминформа”, in *Совещания Коминформа 1947, 1948, 1949. Документы и материалы*, Москва РОССПЭН, 1998, str. 254, 346.

“plani operativ të përbashkët” midis Bullgarisë, Jugosllavisë dhe Shqipërisë, pasi siç u konstatua në mbledhje “tani do të kemi luftë të përbashkët.”³⁹ Më pas, nga tribuna e një mitingu në Kritçim (Bullgari), ku ishte bashkë me E. Hoxhën, i cili kishte shkuar në Bullgari edhe për të nënshkruar një traktat miqësie e bashkëpunimi reciprok, ndërmjet dy vendeve, Gjergj Dimitrov u dërgoi mesazh partizanëve grekë duke u shprehur se fitorja e tyre ishte “nevojë historike për paqen në Ballkan.”⁴⁰

Në fund të dimrit 1947 gueriljet greke numëronin jo më shumë se 10-12 mijë vetë. Por që atë verë ky numër thuhet se u dyfishua dhe zhvillimet në terren duket se ishin në favor të tyre. Partizanët grekë krijuan shtabet rajonale dhe ngritën rrjetin e ndërlidhjes me njëri-tjetrin, si dhe u vu në punë në Beograd radiostacioni “Greqia e Lirë”, prej nga transmetohej tri herë në ditë, fillonte dhe mbaronte me himnin e flamurit, programi i lajmeve të brendshme dhe të jashtme ishte i pasur, sidomos për aktivitetin e DAG. Me propagandën merrej dhe Agjencia e Lajmeve “Elefteri Eladha”, e cila në çdo njësi dhe zonë kishte korrespondentë të saj. Po kështu u hapën shkolla dhe kurse për oficerë dhe nënoficerë, u organizua shërbimi i intendencës, i shëndetësisë etj.⁴¹ Më 23 dhjetor 1947 u shpall Qeveria Demokratike e Përkohshme Greke, nën drejtimin e Markos Vafiadhis.

Në këto rrethana e në këtë frymë, më 19 shkurt 1948, Matias Rakosh, sekretar i Përgjithshëm i PK Hungareze, i kërkoi Mikhail Susllov, atëkohë kryetar i Departamentit të Marrëdhënieve me jashtë pranë KQ të PKBS, të mbahej një mbledhje e radhës e Kominformit⁴² dhe si pikë e parë, sipas tij duhej të ishte njohja e qeverisë së M. Vafiadhis nga qeveritë e Lindjes, në radhë të parë nga fqinjët.⁴³

³⁹ AMPJ, V. 1947, D. 82, fl. 35. Bisedime të zhvilluara në Bullgari, ndërmjet drejtuesve kryesorë të PKB dhe të PKS, si dhe ministrave të Brendshëm përkatës, më 16 dhjetor 1947.

⁴⁰ *ProQuest Historical Newspaper: Christian Science Monitor*, 26 dhjetor 1947. R. H. Markham, “Markos’ Rebel Greek Edict tied to world Communist Plan”, Marrë nga JSTOR.

⁴¹ AQSH, F. 14/AP-Strukturë, Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, V. 1948, Lista 4, Shtojca 2, D. 275/2, “Raport i Drejtorisë së Sigurimit të Shtetit”, 21 maj 1948.

⁴² Është fjala për mbledhjen e dytë të Kominformit, e cila u mbajt më 14 qershor 1948.

⁴³ Leonida Gibianskii, “Коминформ в действии. 1947-1948 гг. По архивным документам”, in. *Новая и Новейшая история*, No. 1. 1996, Moskva: “Наука”, 1996, p. 158.

Por pikërisht për këtë subjekt, disa ditë më parë, më 10 shkurt 1948, në takimin e fshehtë me liderët kryesorë jugosllavë (E.Kardel e M.Gjilas) dhe bullgarë (Gj.Dimitrov), në Moskë, Stalini kishte orientuar të kundërtën, duke u shprehur se shtetet kufitare me Greqinë, me të cilët ai nënkuptonte regjimet komuniste të Jugosllavisë, Bullgarisë e Shqipërisë, duhet ta njihnin të fundit qeverinë e Markos-it. Ndërsa si fillim le ta njihnin ata që ishin më larg, si qeveria hungareze, ajo polake, dhe çekoslovakë. Po në atë mbledhje, Stalini shprehu gjithashtu mosbesim ndaj aftësive të DSE për fitore dhe kërkoi që të ndërpriteshin ndihmat e fqinjëve ndaj ushtrisë greke, gjë që do të thoshte se po kërkohet të ndryshohet qëndrimi.⁴⁴ Vërejmë, pra, se në gjashtë muaj, tri iniciativa të satelitëve, me temë ndihmën ndaj gueriljeve greke, u frenuan nga Moska. Por megjithëqë skeptik ndaj mundësisë së një fitoreje të partizanëve grekë, Stalini gjithsesi ishte i interesuar ta mbante ndezur këtë vatër zjarri. Prandaj, ai edhe u kishte vënë detyrë qeverive komuniste të ndihmonin partizanët grekë, por edhe i frenonte, kur ishte fjala për iniciativa publike. Më të angazhuarat në këtë proces ishin qeveritë e Jugosllavisë, Bullgarisë dhe Shqipërisë me ministrat e Brendshëm të tyre, A.Rankoviç, A.Jugov, K.Xoxe [dhe pas tij M.Shehu], të cilët vazhduan të ishin njerëzit e ngarkuar posaçërisht me ndihmat për partizanët grekë.

Në vitin 1947, kur teatri grek i luftimeve ishte zhvendosur në afërsi të kufirit me Shqipërinë, mund të thuhet se në raport me ngjarjet në Greqi, roli i Tiranës zyrtare erdhi duke u bërë gjithnjë më i ndjeshëm. Në kontekst të kësaj teme, më duhet të kthehem edhe një herë te vizita e parë zyrtare e E. Hoxhës në Kremlin, korrik 1947. Është interesant një vëzhgim i diplomatit amerikan në Beograd, John M. Cabot, që ia dërgonte me këtë rast Sekretarit të Shtetit në Washington DC, George Marshall. Ai vërente se shtypit shqiptar nuk i ishte dhënë asnjë shpjegim për atë vizitë, çka do të thoshte se vizita nuk ishte e gatshme për publicitet. J. M. Cabot e përfundonte njoftimin se, me që në Shqipëri nuk kishte as vrojtues amerikanë e as britanikë, ky vend lehtësisht “mund të përdoret si bazë kryesore për operacione të ardhshme kundër Greqisë.”⁴⁵ Misteri për të rrethuar çështjen greke në bisedimet Stalin - Hoxha është i

⁴⁴ L. Gibianskii, “От первого ко второму совещанию Коминформа ...”, str. 346.

⁴⁵ *National Archives and Records Administration* (më tej: *NARA*), Roll 2, 1945-1950, 875.00/7-2447, më 24.7.1947.

pranishëm edhe në Moskë. Në bisedën e regjistruar që V. Molotov* ka pasur me E. Hoxhën, më 13 korrik 1947, para se ky i fundit të takonte Stalinin, shënohet se problemet e Shqipërisë me fqinjën e saj jugor Greqinë, ishin pika e parë që do të diskutoheshin me Hoxhën. Arkivat ruse i kanë botuar takimet Stalin-Hoxha, por pikërisht për këtë pikë është vënë një shënim, (*удалена-hequr*), gjë që do të thotë se bisedimet për kufirin shqiptaro-grek e çështje të tjera lidhur me marrëdhëniet shqiptare-greke janë lënë jashtë botimit.”⁴⁶ Gjithashtu ‘tepër sekret’ u mbajt edhe marrëveshja që Hoxha nënshkroi në Moskë, sipas së cilës qeveria e BRSS do të furnizonte Shqipërinë me armë, municione dhe mjete teknike ushtarake. Kredia që jepte qeveria sovjetike do të mbulonte 50% të shpenzimeve që nevojiteshin për ushtrinë shqiptare.⁴⁷ Kësisoj, për sa më sipër, na rezulton se diplomati amerikan kishte afërsisht të drejtë. Shqipëria vërtet nuk u përdor “si bazë kryesore për operacione kundër Greqisë”, por nuk vonoi që ajo të kthehej bazë kryesore për furnizimet e gueriljeve greke, përfshirë dhe armët.

Në qershor 1948, pas Rezolutës së Informbyrosë, dhe thyerjes me jugosllavët, Shqipëria mori një rol të veçantë. Ajo u bë porta kryesore ku zbarkoheshin vaporë me armatime, kamionë, ushqime, veshmbathje, ilaçe e gjithçka tjetër që vinte ilegalisht nga vendet e Lindjes për ushtrinë partizane greke. Armatimet dhe mallrat dërgoheshin në kufirin jugor, në rajonin më kryesor të luftimeve, Vici e Gramoz, ku ishte vendosur shtabi i partizanëve, bashkë me udhëheqjen e KKE.

Të gjithë emigrantët grekë që kërkonin strehim në Shqipëri regjistroheshin nga punonjës të Sigurimit në bashkëpunim me strukturat e pushtetit lokal vendas. Në pamundësi për t’i mbajtur të koncentruar në një qendër të vetme, refugjatët grekë u shpërndanë në disa qytete e fshatra, si në Shkodër, Burrel, Elbasan, Bilisht, Llakatund, Fier, Durrës, Vlorë, Tiranë, Peqin, Sukth, Kosovë, Kavajë, gjithsej, 14 600 vetë.⁴⁸ Në

* *Vjačeslav Mihajlovič Molotov*, 25 February 1890 – 8 November 1986. Politikan dhe diplomat sovjetik, kryetar i Këshillit të Komisarëve të Popullit (1930 deri më 1941), dhe Ministër i Punëve të Jashtme (1939-1949, 1953 deri 1956).

⁴⁶ *Восточная Европа, в документах российских архивов, 1944-1953 гг....*, Том I, Документ № 229.

⁴⁷ *AMPJ*, V. 1947, D 1/ 2. Marrëveshje ushtarake e nënshkruar nga Enver Hoxha dhe i plotfuqishmi i BRSS, në Moskë, më 25 korrik 1947.

⁴⁸ *AMPB*, F 54/ Ndihma shqiptare për luftën e popullit grek, V. 1948, D. 94, fl. 1. Informacion mbi një bisedë ndërmjet Qiqicës, anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të DAG me një kuadro të lartë shqiptar, në vitet 1945-1950, dt. 2.12.1948.

Shqipëri, për ta u ndërtuan baraka e kampe për t'u strehuar, për të punuar tokën e për të siguruar prodhime bujqësore, si dhe për t'u kujdesur në mënyrë të organizuar për ruajtjen e bagëtive që kishin sjellë me vete. Gjithashtu u mobilizuan refugjatë grekë me profesione të ndryshme, që ndihmonin në shërbimet si infermierë, kuzhinierë, berberë, ruajtës kafshësh, këpucarë, pastrues, rrobaqepës, furrxhi etj.⁴⁹ U krijuan e u zgjeruan spitale ambulante për të plagosurit dhe të sëmurët, siç ishte spitali i Domosdovës, i Gjirokastrës, i Tiranës, i Fierit, i Llakatundit, i Elbasanit, i Përrenjasit, i Krastës, i Sukthit etj.⁵⁰

Një moment i vështirë për shtetin shqiptar ishte strehimi i fëmijëve grekë. Gjatë viteve 1946-1949, në Shqipëri u strehuan rreth 4000 fëmijë grekë. Grupet e para hynë në Shqipëri në prill 1948, dhe arritën pikun në korrik të atij viti. Ata shoqëroheshin nga kujdestarë të caktuar nga shtabi i DAG, nga nënat dhe kushërinjtë e tyre, por herë-herë ndodhte edhe pa këta të fundit. Kishte shumë fëmijë që nuk dinin ku i kishin prindërit, të vrarë apo në male duke luftuar. Moshë e tyre varionte nga 2 deri në 16 vjeç. 25% e tyre ishin të moshës 2-6 vjeç; 65% ishin 7-13 vjeç; dhe 3.10% ishin 14-16 vjeç. Në tetor 1948, numri i fëmijëve arriti në 3255.⁵¹ Qeveria shqiptare mori masa energjike për ta përballuar situatën e vështirë të fëmijëve, ashtu si të gjithë emigrantëve grekë, me strehim, ushqim, veprimtari kulturore e, për t'u lehtësuar dhimbjen shpirtërore. Fëmijët grekë u vendosën në qendra të koncentruara në periferi të qyteteve ose rretheve të ndryshme, si në Shkodër, Durrës, Elbasan, Vlorë, Fier etj.

Evakuimi i fëmijëve nga zonat e luftës dhe dërgimi i tyre përmes kufirit tokësor të Greqisë në vendet fqinje, si Shqipëria, Jugosllavia e Bullgaria, është quajtur nga qeveria greke e kohës dhe shtypi nacionalist i Athinës (gazeta *Kathemerini* dhe *Eleutheria*) si "Paidomazoma", që do të thotë "Gjenocid". Sipas tyre, ky proces largimi i fëmijëve nga territoret e rrezikuara ku banonin dhe dërgimi në shtetet fqinje synonte përgatitjen e fëmijëve si komunistë, armiq të vendit të tyre, si sllavë e jo grekë.

⁴⁹ *Po aty*, F 54/ Ndihma shqiptare për luftën e popullit grek, V. 1948, D. 261, fl. 1-14. Lista emërore mbi personelin grek të shërbimit pranë spitaleve në Shqipëri, që janë vënë në dispozicion të DAG. Dhjetor 1948 – janar 1949.

⁵⁰ *Po aty*, F 54/ Ndihma shqiptare për luftën e popullit grek, V. 1948, D. 121, 155. Raporte dhe relacione mbi probleme të ndryshme mbi emigracionin grek në Shqipëri.

⁵¹ *Po aty*, F 54/ Ndihma shqiptare për luftën e popullit grek, V. 1948, D. 121, 106, 107; shih gjithashtu: *po aty*, V. 1949, D. 317, 325, 324, 327.

Ndërkohë, shtypi i gueriljeve (*Exormisi*) pohonte se me pëlqimin e prindërve, forcat e DAG kishin marrë fëmijët 2-15-vjeçarë dhe i kishin dërguar në vendet fqinje, pasi qeveria e Markosit kishte bërë marrëveshje me të gjitha qeveritë komuniste, të cilat kishin dhënë miratimin për t'i pranuar fëmijët si “viktima të terrorit politik qeveritar”.

Nga ana tjetër, shtypi i gueriljeve dënonte rrëmbimin e fëmijëve nga zonat e luftës prej forcave policore shtetërore dhe pa lejen e prindërve. Kësaj akuze, qeveria mbretërore i përgjigjej se “fëmijët e kapur ishin lënë rrugëve dhe për ta nuk kujdesej njeri ...” Madje, në vitin 1947, me iniciativën e Mbretëreshës u ndërtuan 58 shtëpi fëmijësh, ku u strehuan fëmijë që banonin në territoret e Greqisë Veriore të marrë pa lejen e prindërve.

Pra, nga të dy krahët e shtypit kishte akuza dhe kundërakuza politike për rrëmbimin e fëmijëve. Nga qeveria greke u bënë protesta të forta në UNSCOB për “rrëmbimin e fëmijëve nga DAG”, në SHBA, sekretari i shtetit George Marshall i quajti akuzat të pamjaftueshme, pasi ka pasur pak ose aspak dokumente që pohojnë se fëmijët janë rrëmbyer me forcë nga shtetet satelite. Kësisoj, u pa e arsyeshme që procesi i hetimit të vazhdonte vetëm nëpërmjet Kryqit të Kuq Ndërkombëtar dhe kështu çështja të trajtohej moralisht. Për akuzat mbi rrëmbimin e fëmijëve nga strukturat qeveritare, UNSCOB nuk bëri investigime.⁵²

Pavarësisht nga akuzat reciproke, mund të pohojmë se të dy palët në thelb synonin shpëtimin e fëmijëve. Nën at dhe prindërit që donin t'i largonin fëmijët nga zonat e luftës, brenda mundësive që kishin. Ndërsa nga ana tjetër, mbretëresha, e cila kishte hapur jetimore për të strehuar fëmijët e gjetur rrugëve, me qëllimin e vetëm për të shpëtuar jetën e tyre. Ndërkohë ajo që ndodhi me fëmijët grekë, dëshmon se fëmijët, shtresa më e pambrojtur e shoqërisë, u gjendën në qendër të konflikteve ideologjike, politike, propagandistike që u zhvilluan gjatë Luftës së Ftohtë. Problemi i fëmijëve refugjatë, preku dhe përplasi nivele të ndryshme të institucioneve shtetërore, sociale dhe morale, që lanë trauma të thella në jetën e mijëra fëmijëve. Një pjesë e tyre u integruan dhe nuk u kthyen fare në Greqi, kurse të tjerë vetëm pas 30 vjetësh, kur ishte

⁵² Lars Berentzen, “The “Paidomazoma” and the Queen’s Camp”, në *Studies in the History of the Greek Civil War 1945-1949*, eds. Lars Berentzen, John O. Iatrides, Ole L. Smith, Copenhagen: Museum Tusulanum Press, 1987, pp. 127-155.

miratuar ligji “Për pajtimin kombëtar” arritën që të hyjnë në atdheun e tyre si qytetarë të ligjshëm.

Qeveria shqiptare nuk pranoi kërkesën e qeverisë mbretërore greke për riatdhesimin e fëmijëve grekë dhe as të bashkëpunonte me Kryqin e Kuq Ndërkombëtar e strukturat e tjera ndërkombëtare për këtë qëllim. Nga Shqipëria, fëmijët grekë filluan të largohen në dhjetor 1948, nëpërmjet Jugosllavisë për në Rumani, Poloni, Çekosllovakia, Gjermaninë Lindore dhe Hungari. Për emrat, numrin, datën dhe vendin ku dorëzoheshin fëmijët grekë janë mbajtur procesverbale të rregullta, të cilët ruhen edhe sot në arkivat shqiptare.

Vetëm pasi fëmijët kishin kapërcyer kufirin Shqipëri-Jugosllavi, qeveria shqiptare më 19 prill 1949, deklaroi në OKB se në Shqipëri nuk gjendeshin fëmijë grekë.

Gjithashtu, që në muajt e parë të vitit 1948, nën shembullin jugosllav, qeveritë komuniste të Evropës Lindore krijuan në vendet e tyre komitete ndihmash për partizanët grekë. Gjatë marsit, të tilla komitete u ngritën edhe në të gjitha qendrat administrative të Shqipërisë.⁵³ Ato u quajtën “Komitetet e ndihmës për popullin grek” për të treguar se ishte populli ai që po luftonte. Komitetet e PKSh në rrethe u udhëzuan t’u shpjegohej njerëzve se populli grek po luftonte që Greqia të mos kthehej në “vatër agresioni kundër paqes dhe demokracisë në Ballkan dhe sidomos kundër paqes dhe demokracisë në Shqipëri”.⁵⁴ Duket se kjo propagandë zuri vend, pasi në informacionet e ardhura thuhej se familjet e varfra shqiptare jo vetëm ishin të gatshme të ndanin kafshatën e gojës, por kishte dhe prej atyre që kërkuan të shkonin në frontin e luftës.⁵⁵ “Ne

⁵³ AMPB, F. 54/Drejtoria e Zbulimit Politik, V. 1948, D. 201. Ideja për krijimin e komiteve për të ndihmuar popullin grek u shfaq për herë të parë në Beograd, në nëntor 1947, me rastin e një konsulte të përfaqësuesve të lëvizjes sindikale të vendeve të Ballkanit. Në Shqipëri, “Komiteti shqiptar i ndihmave për popullin demokrat grek” u krijua disa muaj më vonë, më 28 shkurt 1948. Ai e shtriu veprimtarinë e tij në të gjithë vendin, duke krijuar 27 komitete në 27 rrethet e Shqipërisë. Komitetet vepronin pranë këshillit sindikal të çdo rrethi. Ndërsa në fshatra ishte ngarkuar Fronti Demokratik për ta kryer këtë mision.

⁵⁴ AQSH, F. 14/AP-Str, V. 1948, D. 611. Udhëzime të dërguara nga KQ i PKSH gjithë komiteve të Partisë, për qëndrimin që duhej të mbanin shqiptarët ndaj Luftës Civile në Greqi, 16 mars 1948.

⁵⁵ Po aty, F 14/AP-Str, V. 1948, D. 600.

Shqipërinë e kemi si shtëpinë tonë”,⁵⁶ u shpreh kreu i komunistëve grekë, N. Zahariadhis, në një takim që pati me K. Xoxen, më 9 qershor 1948, në Korçë, teksa udhëtonte për në Beograd. Autoritetet shqiptare u përpoqën ta paraqesin si të ligjshme veprimtarinë e tyre të anuar në Luftën Civile në Greqi, duke e konsideruar e propaganduar atë vetëm si ndihmë ndaj një populli të përndjekur.⁵⁷ Por pjesa “legale” ishte vetëm mbulesa e një veprimtarie mjaft problematike për statusin ndërkombëtar të Shqipërisë.

Kufiri shqiptar nuk ishte i hapur vetëm për popullsinë refugjate, madje as vetëm për partizanët e plagosur. Në kufirin me Shqipërinë vullnetarët e ardhur nga vende të ndryshme, për të luftuar në radhët e DAG hynin pa u penguar. Edhe njësitet e armatosura partizane greke hynin e dilnin vazhdimisht. Ka udhëzime dhe vendime të MPB se si do të veprohej me kategori të ndryshme të shtetasve grekë që hynin në tokën shqiptare, për regjistrimin e emrave, për faturat e shpenzimeve, për marrjen e dëshmimeve të ushtarëve dhe oficerëve të Ushtrisë Qeveritare Greke të kapur rob, për takimet me drejtuesit e lartë të DAG dhe KKE etj. Të gjitha këto veprime bëheshin në konspiracion të plotë. Sipas udhëzimeve të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Shqipërisë, njësitet greke që hynin në tokën shqiptare duhej të qëndronin në vende të pyllëzuara pranë kufirit, nuk duhej të takoheshin me askënd, ushqimi u duhej çuar fshehurazi, lëvizjet e tyre duheshin bërë vetëm natën dhe në fund duhej zhdukur çdo lloj gjurme.⁵⁸

Në raste të caktuara kufiri u përdor edhe për manovra ushtarake. Se si veprohej në raste të tilla, këtë na e thotë mjaft qartë një raport për lëvizjen e formacioneve partizane greke në tokën shqiptare natën e 27-28

⁵⁶ *Po aty*, F 14/AP - Marrëdhëniet me Partinë Komuniste Greke (MPKG), V. 1948, D. 3. Biseda ime me Nikon [Zahariadhi], më 9 qershor 1948, ora 12, në drekë.

⁵⁷ *Statuti i Republikës Popullore të Shqipërisë*, Tiranë: 1946, art. 36, fl. 11. Në Kushtetutën Shqiptare të vitit 1946 thuhej se “Republika Popullore e Shqipërisë u jep të drejtë strehimi në tokën e saj shtetasve të huaj, të ndjekur për shkak të veprimtarisë së tyre në favor të demokracisë, të luftës nacional-çlirimtare, të të drejtave të popullit punëtor...”

⁵⁸ *AMPB*, F. 54/Drejtorja e Zbulimit Politik, V. 1946, D. 101; D. 117; V. 1947, D. 156. Mehmet Shehu në urdhrin e dt. 29 korrik 1947 shkruante: “Elementët grekë, qofshin këta monarko-fashistë ose demokratë, që iu dorëzohen forcave tona, mbasi të jenë marrë në pyetje sipas udhëzimeve që ka dhënë seksioni i Zbulimit, t’u kalohen menjëherë Drejtorive të brendshme të Prefekturave, të cilat kanë urdhra të veçantë për mënyrën e trajtimit të tyre... Në rast se këta elementë janë të armatosur, t’u tërhiqet armatimi me procesverbale dhe të merret në dorëzim duke i dërguar një kopje të procesit Drejtorisë së Brendshme të Prefekturës...”

marsit 1949. Sipas këtij raporti, më 23 mars, Niko Zahariadhisi [Nikos Zachariadis]*, kryetar i KKE, u takua në Tiranë me Mehmet Shehun**, ministrin e Brendshëm shqiptar. Kryetari grek i Këshillit të Luftës i paraqiti Shehut planin për të asgjësuar “një brigadë e gjysëm monarko-fashistësh”, që mbanin territorin ndërmjet Vicit dhe Gramozit. Qëllimi i operacionit ishte të bashkoheshin këto dy zona të çliruara. Për këtë arsye, një pjesë e forcave greke duhej të kalonte përmes tokës shqiptare, duke siguruar se gjithçka “do të bëhej natën, me makina, në mënyrë shumë konspirative dhe pa armë”. Kjo leje u dha, dhe natën e 27-28 marsit, afërsisht një divizion, me gati tre mijë vetë, me mjete të motorizuara dhe 400 kuaj, hynë në territorin shqiptar nga Kapshtica dhe që andej kaluan përsëri në tokën greke, në Gramoz, për të vazhduar luftimet.⁵⁹

Po në këtë raport informohej se në Shqipëri gjendeshin rreth 8 mijë refugjatë grekë, dhe rreth 1200 të plagosur. Të plagosurit apo të sëmurët, pasi shëroheshin, ktheheshin përsëri në luftime. Në ndihmë të të plagosurve, në spitalet shqiptare ishin edhe gjashtë mjekë dhe infermierë hungarezë, si dhe dy mjekë polakë. Mësohet po ashtu se në Tiranë, Shtabi i DAG kishte një përfaqësues të vetin, bashkë me personelin; një radiostacion në territorin shqiptar; ndërsa në Korçë një shtypshkronjë. Në kufi kishte gjashtë kanale aktive për të evaduar materialet e luftës.⁶⁰ Funkcionet e kanaleve ishin të shumëfishta. Ata përdoreshin për grumbullimin, depozitimin, ruajtjen e materialeve që vinin nga Tirana për t’iu dërguar Ushtrisë Demokratike. Puna nëpërmjet këtyre kanaleve ishte tepër konspirative dhe për këtë arsye më së shumti bëhej natën me qëllim që të mos dyshonte as popullsia e fshatit ose e zonës përreth. Gjithashtu nëpërmjet këtyre kanaleve transportohen të plagosurit në LCG, të cilët dërgohen në spitalin më të afërt ose në spitalin e caktuar për ushtarët e plagosur në luftimet në Greqi. Herë pas here kanalet ndryshojnë dhe në

* *Niko Zahariadhisi* [27 prill 1903 - 8 gusht 1973]. Sekretar i Përgjithshëm i KKE (1931-1956), Komandant i Përgjithshëm i DAG (1949). Nuk është e sigurt nëse ka kryer vetëvrasje apo e kanë vrarë agjentët e KGB në BRSS.

** *Mehmet Shehu* [1913-1981]. Shef i Shtatmadhorisë së Ushtrisë Shqiptare (1946-1947), ministër i Brendshëm (1948-1954), Kryeministër (1954-1981). Si datë e vdekjes së tij shënohet 18 dhjetori 1981. Zyrtarisht është deklaruar se kreu vetëvrasje, por në opinionin publik ende ka dyshime se e kanë vrarë.

⁵⁹ *AQSH*, F. 14/AP - MPKG, V. 1949, D. 2. fl.1-3, 14.4.1949. Përdorimi i kufirit shqiptar nga formacionet e Ushtrisë Demokratike Greke.

⁶⁰ *Po aty*.

vendin ku ata kanë funksionuar nuk lihet asnjë gjurmë materiale që ka lidhje me to.⁶¹

E gjithë kjo veprimtari, bëri që qeveria shqiptare të vihej gjithnjë e më shumë nën presionin ndërkombëtar. Që më 3 dhjetor 1946, delegacioni grek në OKB i kishte paraqitur Sekretarit të Përgjithshëm një memorandum të qeverisë së tij, sipas të cilit Shqipëria, Jugosllavia dhe Bullgaria ishin duke u dhënë “mbështetje gueriljeve të dhunshme kundër rendit publik dhe integritetit territorial” të Greqisë dhe se kjo situatë “ka të ngjarë të rrezikojë ruajtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare”, prandaj ajo i kërkonte Këshillit të Sigurimit një investigim për këtë çështje.⁶²

Më 10 dhjetor 1946 u hap diskutimi për memorandumun grek dhe më 19 dhjetor 1946, Këshilli i Sigurimit vendosi të ngrihet një *Komision Hetimor* që do të vëzhgonte gjendjen. Asambleja e Përgjithshme e OKB e ngriti Komisionin Hetimor të rekomanduar, e më pas (1947) edhe një *Komision Special për Ballkanin, UNSCOB* (United Nations Special Commission on the Balkans) me të cilin u kërkoi bashkëpunim qeverive të sipërpërmendura. Qeveria shqiptare, sipas udhëzimeve sovjetike, e këshilluar me jugosllavët,⁶³ por edhe me bullgarët,⁶⁴ u përgjigj më 23 dhjetor 1947 se e konsideronte Komisionin si të krijuar kundër principeve të Kartës së OKB dhe, si të tillë, nuk e njihte dhe nuk bashkëpunonte me të.⁶⁵

Më 30 qershor 1948, UNSCOB i paraqiti Asamblesë së Përgjithshme të OKB raportin e tij të parë. Sipas raportit, gueriljet greke merrnin ndihmë nga Jugosllavia, Shqipëria dhe Bullgaria. Duke përshkruar

⁶¹ AMPB, F. 66/Dega e Brendshme e Gjirokastrës, V. 1949, D. 71. fl. 37-39.

⁶² AMPJ, V. 1946, D. 60. Memorandum i grek i dhjetorit 1946.

⁶³ AQSH, F. 14/AP-OU, V. 1947, D. 23. Të nesërmen e kthimit nga Moska, më 27 korrik 1947, E. Hoxha me disa nga anëtarët e delegacionit shqiptar raportuan në mbledhjen e Byrosë Politike për përfundimet e vizitës në BS. Por ky raportim ishte i pjesshëm. Drejtori për Ballkanin në Ministrinë e Punëve të Jashtme të BS, A. Llavriçev, i kishte thënë H. Kapos: “Për nënkomisionin në kufirin grek qëndrimi juaj duhet të jetë si ai i jugosllavëve”.

⁶⁴ AMPJ, V. 1947, D. 82. Sipas shënimeve të mbajtura gjatë vizitës së E. Hoxhës në Bullgari, në takimin për Komunikatën e përbashkët, më 16 dhjetor 1947, E. Hoxha i ka kërkuar Dimitrovit që në Komunikatë të shënohej se “jo vetëm nuk e pranojmë komisionin e UNO-së, që ndodhet në Greqi, por as çdo nënkomision tjetër të tij”.

⁶⁵ AMPJ, V. 1949, D. 93, fl. 1-4. Raport përmbledhës i MPJ të Shqipërisë mbi marrëdhëniet me UNO-në për çështjen greke.

karakterin, shkallën, mënyrat e dhënies së ndihmës, raporti i UNSCOB konkludonte se kjo mbështetje realizohej “me dijeninë e qeverisë së Shqipërisë, Bullgarisë dhe të Jugosllavisë.” Komiteti ishte i bindur se për sa kohë situata përgjatë kufijve veriorë dëshmonte një mbështetje të tillë, pavarësia politike, paqja dhe siguria territoriale në Ballkan do të mbeteshin të kërcënuar.⁶⁶

Më 2 gusht 1949 një raport tjetër i UNSCOB-it shënonte se Shqipëria ishte burimi kryesor i ndihmës dhe kjo ishte “vitale për vazhdimësinë e lëvizjes së guerileve greke, qëkurse të gjitha përqendrimet guerilase u gjendën në kufirin shqiptar”.⁶⁷ Në këto raporte shënohej gjithashtu se “... qeverisë shqiptare i binte përgjegjësia kryesore për vënien në rrezik të paqes në Ballkan ...”⁶⁸ Në fakt, raporti i UNSCOB-it kishte të drejtë, sepse pas thyerjes sovjeto-jugosllave dhe mbylljes së kufirit nga Tito në Kajmakçalan, më 23 korrik 1949, burimi i mbështetjes së DAG ishte Shqipëria, jo Jugosllavia. Por Hoxha në asnjë rast nuk i pranoi konkluzionet e komisioneve të Kombeve të Bashkuara. Në një varg fjalimesh të mbajtura në vitet 1947-1949, ai ka përgënjeshtuar implikimin e qeverisë shqiptare në Luftën Civile në Greqi. Megjithëse dokumentet ‘flasin’ për mijëra fishekë, bomba, pushkë, mitralozë, revolverë, mortaja, topa, dërguar nga Shqipëria në Greqi,⁶⁹ në tetor të vitit 1947, në fjalimin e tij mbajtur përpara popullit të Përmetit, Hoxha deklaronte se: “Ata [qeveria amerikane dhe britanike] na akuzojnë se gjoja ne i japim armë ushtrisë demokratike greke. Këto s’janë të vërteta ... Populli grek ka luftuar e lufton për lirinë e tij; kjo është një punë e popullit grek. Këtë le ta zgjidhin vetë. Ne as jemi përzier e as përzihemi në punët e brendshme të Greqisë”⁷⁰; Po me këtë gjuhë, Hoxha ka folur dhe në Kuvendin e Shqipërisë: “Populli ynë, është shprehur ai, kurrë nuk

⁶⁶ *Po aty*, V. 1949, D. 114. Raporti i parë i UNSCOB i paraqitur në Asambleenë e Kombeve të Bashkuara, më 30 qershor 1948; shih gjithashtu: *The Department of State Bulletin*. “Greece and the United Nations 1946-1949”. A Summary Record by Harry N. Howard”, p. 3-21.

⁶⁷ Stavro Skendi, “Albania”, *The Fate of East Central Europe: Hopes and Failures of American Foreign Policy Pub.*, University of Notre Dame Press, 1956, p. 301-310.

⁶⁸ *Po aty*.

⁶⁹ *MPB*, F 54/Ndihma shqiptare për luftën e popullit grek, V. 1949, D. 311, 10 maj 1949. Evidenca për shpenzimet e bëra nga Shqipëria për luftën e popullit grek.

⁷⁰ Enver Hoxha, *Vepra 4*, Tiranë: Naim Frashëri, 1970, f. 270.

i ka ndihmuar demokratët grekë me armë dhe me municion dhe shpifjet e amerikanëve dhe anglezëve mbeten kurdoherë shpifje.”⁷¹

Më 4 prill 1949, qeveria greke, me anë të ambasadës së saj në Londër, i dorëzoi Foreign Office një memorandum, sipas të cilit nëse do të kishte ndërhyrje të forcave të Informbyrosë në Jugosllavi, “një veprim i shpejtë i Aleatëve në Shqipëri do të ishte gjëja më e mirë dhe mjeti më efektiv për të penguar pasojat e mundshme të përparimit rus në Jugosllavi”.⁷² Me të njëjtën përmbajtje një memorandum si ky i ishte paraqitur më 1 prill, edhe qeverisë amerikane, sipas të cilit “një operacion naval i Fuqive Perëndimore” kundër Shqipërisë “do të sillte me siguri kolapsin e shpejtë të regjimit të Hoxhës.”⁷³

Kërkesa greke nuk kaloi në heshtje. Më 5 prill 1949, Sekretari i Shtetit Dean Acheson, njoftoi ambasadorin amerikan në Athinë se një raport *synopsis* i dt. 31 mars ishte paraqitur dhe diskutuar në Washington D.C. në nivelet më të larta britanike dhe amerikane, ku ndër të tjera rekomandohej asistencë ushtarake për Greqinë. Sekretari i Shtetit kërkonte mendimin e ambasadorit “në dritën e zhvillimeve të përgjithshme në Ballkan në rast se Kominformi triumfonte në Jugosllavi”.⁷⁴

Me sa duket, i informuar për këto lëvizje, Stalini thërret me urgjencë Zahariadhisin në Moskë. Më 11 prill 1949, atij iu komunikua mbyllja e të gjitha operacioneve të DAG. Përndryshe, nëse do të vazhdonin luftimet

⁷¹ “Fjala e Kryeministrit E. Hoxha në Kuvendin Popullor të RPSH”, në *Bashkimi*, nr. 961, Tiranë: 28 janar 1948.

⁷² TNA, FO 371/78398/4018, 4 April 1949. Published by Basil Kontis in the book *H azgloamerikanikη politikη kai to Ellhniko problhμα: 1945-1949*, Θεσσαλονικη: 1984, Θεματα Νεοελληνικησ Ιστοριασ, pp. 465-472; shih edhe: Peter J. Stavrakis, *Moscow and Greek Communism, 1944-1949*, Ithaca and London: Cornell University Press, 1989, p. 182.

⁷³ *Foreign Relations of United States of America* (më tej: *FRUS*), 1949, Vol. VI, Moscow Embassy files: Lot F-132. Memorandum of conversation between Leonard J. Cromie and Vasili Dendramis, the Greek Ambassador in USA, 1 April 1949, (Top Secret), Washington D.C., 1977 (Memorandum bashkëbisedimi ndërmjet Leonard J. Cromie dhe Vasili Dendramis, ambasadorin grek në SHBA, 1 prill 1949), (shumë sekret), Washington D.C., 1977), p. 288.

⁷⁴ *Po aty*, 1949, Vol. VI, 868.00/4-549. Telegram i Sekretarit të Shtetit dërguar ambasadës së SHBA në Greqi, Washington, 5 prill, 1949-6 p.m. Washington D.C., 1977, f. 290-291.

me humbjet e muajve të fundit, atëherë jo vetëm Greqia, por edhe pushtimi i Shqipërisë ishte i paevitueshëm.⁷⁵

Ndërkohë që Zahariadhis u kthye përsëri në Gramoz dhe i transmetoi komandantëve të DAG direktivat e reja, Stalini dërgoi në Tiranë ambasadorin sovjetik Çuvahin. Më 25 prill, i sapokthyer nga Moska, brenda ditës, ai i përcolli E. Hoxhës dy porosi të qeverisë së tij. Porosia e parë thoshte se duke filluar nga 1 maji të mbyllej kufiri me Greqinë, si për shtetasit grekë ashtu dhe për ndihmat. Partizanët grekë, që do të hynin në Shqipëri, duhej të çarmatoseshin dhe të çoheshin në thellësi të vendit. Porosia tjetër ishte forcimi i ruajtjes së kufirit me Jugosllavinë. Ambasadori sovjetik transmetoi edhe premtimin se qeveria sovjetike do të ndihmonte ushtrinë shqiptare me financime dhe me përgatitje specialistësh.⁷⁶

Zhvillime të reja lidhur me Luftën Civile Greke po ndodhnin edhe në metropolet ndërkombëtare. Një darkë informale më 20 prill 1949 ndërmjet Trygve Lie, Sekretari i Përgjithshëm i OKB, Dean Rusk, zëvendëssekretari i Shtetit, dhe Andrei Gromyko, zëvendësministri sovjetik (e më 26 prill me Dean Rusk, zëvendëssekretari i Shtetit, dhe Andrei Gromyko, zëvendësministri sovjetik dhe Hector McNeil, me delegatin britanik në Asamblenë e Përgjithshme), jashtë ambienteve të OKB, bëri që të ndryshojë rrjedha e LC në Greqi. Në ato takime që në fillim u shtrua pyetja nëse qeveritë e BS, Shteteve të Bashkuara dhe të Britanisë së Madhe mund të bënin diçka për të zgjidhur situatën në Greqi.⁷⁷ Gromyko e perceptoi pyetjen si ftesë për negociatë, dhe, menjëherë lajmëroi Stalinin në Moskë. Ky i fundit, i cili kishte ndërmarrë disa hapa paqëtues dhe të kujdesshëm për t'i dhënë fund Luftës Civile në Greqi me sa më pak humbje dhe për të ruajtur një qoshe komuniste në Shqipëri, dha siguri që partizanët grekë do t'i ulnin armët. Me bisedime të mëtejshme, Stalini arriti një zgjidhje negociuese ndaj luftës dhe kësioj, alternativa për ndërhyrje ushtarake nga Perëndimi në Shqipëri, që

⁷⁵ P. J. Stavrakis, *Moscow and Greek Communism ...*, p. 182.

⁷⁶ *Восточная Европа, в документах российских архивов, 1944-1953 гг. Том II, 1949-1953 гг.*, Москва – Новосибирск: Сибирский хронограф, 1997, Документ № 26. Regjistrim i bisedës së ambasadorit Çuvahin me E. Hoxhën, më 25 prill 1949.

⁷⁷ DSR 868.00/5-549, memorandum of conversation, in B. Kondis, *Η αγγλοαμερικανική πολιτική και το Ελληνικό πρόβλημα...*, pp. 473-78; shih gjithashtu: Dimitris Gousidis, ed., *Markos Vafeiadis: Martyries*, Athens: Epikairoitota, 1983, p. 51. Citimet marrë nga P. Stavrakis, *Moscow and Greek Communism ...*, p. 183.

diskutohej jo rrallë në media e në kancelaritë amerikane e britanike, u shmang.

Kronika e mësipërme nxit mjaft komente: *Për grekët*: Një ndërhyrje në Shqipëri jo vetëm do të ndërpriste kanalin e ndihmave, që u shkronin gueriljeve përmes saj, po sidomos do të krijonte rrethana të përshtatshme për plotësimin e lakmisë greke të ndryshimit të kufijve. *Për anglo-amerikanët*: gjithçka ishte në varësi të zhvillimeve brenda Bllokut Komunist, nëse do të përdorej ose jo ndërhyrja ushtarake e Moskës në Jugosllavi. Dhe *për sovjetikët*: braktisja e një kauze të humbur, siç ishte lufta e gueriljeve, ishte mundësia e vetme që Moska të ndjehej e patrazuar në planet e saj afatshkurtra për kompaktësimin e Bllokut. Për sa u përket udhëheqjeve *komuniste greke dhe asaj shqiptare*, as KKE nuk e ndërpreu luftën për katër muajt e ardhshëm, por as PKSH nuk i ndërpreu ndihmat për grekët dhe nuk i mbylli kufijtë.

Muajt e fundit të rezistencës ishin rrënues për lëvizjen guerile. Humbja e parë ishte ajo e Vicit, e cila filloi më 10 gusht 1949. Për humbjen në Vici dhe për perspektivën e Gramozit u diskutua edhe midis Hoxhës dhe Zahariadhisit, të cilët më 14 gusht u takuan në Korçë. Si Shehu ashtu edhe Hoxha u shprehën se pas disfatës në Vici, kjo betejë do të ishte katastrofë për gueriljet, për shkak se Gramozi “ishte një zonë e mbyllur dhe i jepte mundësi kundërshtarit të përqendronte sulmin.”⁷⁸ Por grekët nuk i dëgjuan këshillat. Ashtu siç pritej, më 24 gusht 1949, ra edhe Gramozi, fortesa e fundit e gueriljeve. Më 28 gusht të gjithë partizanët grekë që luftuan në Gramoz, rreth 13 mijë vetë, e lanë për herë të fundit tokën e tyre dhe kaluan në territorin shqiptar. Bashkë me ta, në Shqipëri hyri gjithë Byroja Politike e KKE dhe drejtuesit e ushtrisë. Tërheqja e luftëtarëve ishte e çrregullt dhe në mesin e ushtarëve dhe oficerëve shqiptarë, ishin përhapur disa mendime: “Çfarë ishte duke ndodhur? A ishin tradhtuar? Ata u mundën më keq se italianët! Drejtuesit nuk i kanë udhëhequr ata mirë.”⁷⁹ Dy humbje të partizanëve në Vici e Gramoz, në gusht 1949 shënuan fundin e luftës. Ajo që ndodhi në gusht 1949, për gueriljet ishte mjaft shkurajuese, ndërsa për udhëheqjen shqiptare, e cila i kishte mbështetur ato pa mëdyshje, ishte zhgënjyese.

Që prej fundit të gushtit ka disa takime midis udhëheqësve grekë të luftës, tashmë të ardhur në Shqipëri dhe zyrtarëve shqiptarë, si dhe disa

⁷⁸ *AQSH*, F. 14/AP-OU, V. 1949, D. 53.

⁷⁹ *AQFA*, F. Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë, bobina 17, V. 1949, D. 157, fl. 42-43.

letërkëmbime të Byrosë Politike të KKE me KQ të PPSH-së. Ndër letrat e fundit të drejtuesve grekë është ajo e 27 tetorit 1949, me të cilën ata kërkuan zyrtarisht të vendosnin organet drejtuese të KKE dhe Shtabin e DAG në Shqipëri. “Shqipëria, thuhej në letër, gjeografikisht është vendi më i përshtatshëm nga çdo vend tjetër për udhëheqjen e veprimtarisë së KKE në Greqi, nga jashtë.”⁸⁰ Udhëheqësit grekë kishin shkuar shumë larg me kërkesat e tyre (!). Një hap si ky ishte me mjaft rreziqe për pavarësinë e Shqipërisë, pasi e shndërronte atë në aktore të drejtpërdrejtë në Luftën Civile greke, pra dhe në shënjestrën ndërkombëtare të goditjes.

Por ajo që bën përshtypje është se në këtë letër, veç kërkesës, gjenden edhe një varg akuzash për udhëheqjen shqiptare, aq sa është vështirë të kuptosh nëse udhëheqësit grekë shpresonin vërtet në plotësimin e kërkesës së tyre, apo provokonin me qëllim që kërkesa të refuzohej. Në këtë çast delikat, në fakt, udhëheqja shqiptare u tregua realiste në vlerësimin e situatës.

Më 1 nëntor, Hoxha informoi KQ të PKBS për letrën “denigruese” dhe për grupin e Niko Zahariadhisit që “pretendojnë ta përdorin tokën shqiptare si një bazë për të zhvilluar një aktivitet të shumanshëm dhe pa kontroll e, në të njëjtën kohë, akuzojnë udhëheqjen tonë si trockistetitiste”. Hoxha kërkoj që Zahariadhisi me grupin e tij “të largoheshin menjëherë nga Shqipëria si njerëz të padëshirueshëm.”⁸¹

Për të qetësuar mosmarrëveshjet, Stalini i takoi të dyja palët së bashku në Moskë, në janar 1950. Në takimin e Moskës, ku merrnin pjesë drejtues të lartë shqiptarë e grekë, secila palë qëndroi në pozicionet e veta. Ndoshta për Stalinin nuk kishte shumë rëndësi marrëdhënia e ardhshme midis dy partnerëve që kishte thirrur në tryezë, për deri sa misioni konsiderohej i mbyllur. Gjithsesi, ajo çka Stalini e vërejti të udhës ishte që Shqipëria duhej lehtësuar. Kështu që komunistët dhe refugjatët grekë u larguan pjesë-pjesë për në BS dhe vendet e tjera të Evropës Lindore, sidomos në Poloni dhe Hungari.

Duhet shtuar se Stalini e pa të udhës që një pjesë e ish luftëtarëve grekë në Shqipëri, të cilët ishin kthyer në emigrantë refugjatë, t'i largonte jo vetëm nga Shqipëria, por edhe nga Evropa. Një pjesë e tyre u dërguan

⁸⁰ *AQSH*, F.14/AP - MPKG, V. 1949, D. 3. fl. 1-3. Mbledhje e Byrosë Politike të PPSH, ku analizohet letra e udhëheqësve të KKE drejtuar KQ të PPSH, për të drejtuar luftën nga territori shqiptar, më 27 tetor 1949.

⁸¹ *Po aty*, fl. 1-5. Letër e KQ të PPSH drejtuar KQ të PK(b) të BS, për largimin e udhëheqjes së KKE që ndodhej në Shqipëri, më 1 nëntor 1949.

në Tashkent-Uzbekistan, ku u trajnuan në shkolla ushtarake dhe mendonin të përgatiteshin e të ktheheshin sërish në Greqi për të luftuar kundër qeverisë greke.

Në Shqipëri qëndruan rreth 350 vetë, ushtarë të ushtrisë qeveritare greke, që i quanin “Robërit monarko-fashistë”. Ata mbetën në Shqipëri deri në vitet 1956-1957. Lirimin e tyre, qeveria greke e vuri si kusht të parë për normalizimin e marrëdhënieve me Shqipërinë. Por u desh të kalonin dekada që të zbehej kujtesa e asaj çka kishte ndodhur në vitet 1946-1949. Mbështetja që Shqipëria u dha gueriljeve greke ishte me kosto të lartë ekonomike, politike, sociale për të. Ishte një rreshtim i gabuar që Shqipërisë i rrezikoi integritetin territorial, i krijoi izolim ndërkombëtar, i kushtoi viktima në njerëz e dëme materiale.

Lufta Civile Greke ishte një nga betejat ideologjike më të ashpra e me pasoja të thella sociale për popullin grek e për popujt e tjerë që morën pjesë në të, gjatë Luftës së Ftohtë. Megjithatë siç shprehet studiuesi i njohur John O. Iatrides, Lufta Civile Greke për Stalinin, ishte një betejë e vogël në Luftën e Ftohtë, një betejë që ai do të kishte dashur ta fitonte, por ai mundi ta përballojë mirë humbjen.

S u m m a r y

ALBANIA'S IMPLICATIONS IN THE GREEK CIVIL WAR 1946-1949

The historical literature has mentioned Albania as passing, mostly as a possibility for shelter or transit for the Greek partisans during the Greek Civil War. But the documents from the Albanian archives on relations with the Greek Communist Party (Kommounistikó Kómma Elládas -KKE) and its army, (Greek Democratic Army -GDA), recently declassified, suggest that Albania's investment was more than that. Albania was forced to pick up the slack, often finding itself in difficulty or in delicate situations.

Starting from 1946 to 1949, Albania was heavily penalized from the UN more than her neighbors for assisting the Greek partisans. It was defined as “a center of aggression against peace and democracy in the Balkans and especially against peace and democracy in Albania.”

At the beginning Albanian Communist Party (PKSH) leadership cooperated with Yugoslav Communist Party (PKJ) leadership to support the

Greek Communist Party (via Interior ministries) but when the theater of the Greek war moved closer to the Albanian border, and especially after the Cominform Resolution, Tirana's role in the Greek affairs became more pronounced to the Greek guerrillas: armament and food supply, Domosdova's hospital for Greek partisans and civil population, movement partisan units via bordering lines, and relations between both leaderships, Albanian and Greek ones. So, Albania's border was not only opened to wounded Greek partisans and refugees. Once in a while, it also became a site of military maneuvers.

One of the most interesting point will be the relations between Albanian and Greek communist leaders, where is included Marco Vafiadhis too, before and after Comintern Resolution. Their relations have been at the meetings in person and through written letters (uncial copies) exchanged among each others. All the main Greek leaders had special passing documents released by Albanian Interior ministry. "In Albania we feel right at home," noted the Greek leaders.

It is against this background that a series of disagreements erupted between the PKSH and the KKE especially in 1949. My paper will shed light on the Albanian-Soviet relations on Greek –Albanian relations during Greek Civil war and little bit after.

At last, evidencing the repercussions to Albanian state and Albanian people from the attitude of the ACP leadership, my paper will withdraw some conclusions why Albania undertook this difficult burden to involve in the Greek Civil war. Generally it was a disappointed epilogue for the Albanian – Greek relations and the Albanian people, who thought that was sacrificed for a right cause.